

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë OSHEE / Adm / Departamenti i Informacionit dhe Inovacionit / Drejtoria e Inovacionit dhe Forcimit të Përvojës së Klientit / Sektori i Inovacionit.

SPECIALIST

Specialisti i Inovacionit luan një rol të rëndësishëm në identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve inovative brenda shoqërisë, duke mbështetur përpjekjet për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e përvojës së klientit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbledh ide inovative nga departamentet e ndryshme dhe përgatit analiza vlerësimi për propozimet.
- Propozon vetë ide inovative bazuar në hulumtime, trende të tregut dhe praktikat më të mira.
- Sugjeron përmirësime për procese dhe shërbime ekzistuese.
- Eksploron mundësi për përmirësime në proceset dhe shërbimet ekzistuese.
- Përcakton prioritetet për projektet inovative bazuar në fizibilitet dhe ndikimin e pritshëm.
- Ndihmon në organizimin e ëorkshop-eve, hackathon-eve dhe takimeve brainstorming.
- Promovon kulturën e inovacionit dhe nxit angazhimin e stafit.
- Monitoron progresin e projekteve inovative dhe dokumenton të gjitha fazat e projekteve.
- Raporton progresin dhe sfidat e hasura tek Shefi i Sektorit të Inovacionit.
- Siguron koordinim efektiv ndërmjet departamenteve të përfshira.
- Ofron zgjidhje kreative për sfidat që dalin gjatë zbatimit të projekteve.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë universitare në Inxhinieri, Teknologji Informacioni ose fusha të ngjashme.
- Përvojë e mëparshme në projekte ose role të lidhura me inovacionin.
- Aftësi shumë të mira analitike dhe zgjidhje të problemeve.
- Njohuri të mira të përdorimit të teknologjisë dhe mjeteve digjitale.
- Prirje për kreativitet dhe mendim strategjik.
- Përvojë në organizimin e eventeve dhe aktiviteteve të inovacionit si workshop-e dhe hackathon-e.
- Aftësi në përdorimin e mjeteve të menaxhimit të projekteve si Trello, Asana ose Jira.
- Njohuri mbi praktikat më të mira në menaxhimin e inovacionit në sektorin publik dhe privat.

- Eksperiencë në hulumtim tregu dhe analizë konkurruese për identifikimin e mundësive të reja të biznesit

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.